



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 5835/Prot.
11

Tiranë, më 24.07. 2026

U D H Ë Z I M

Nr. 13, datë 24.07. 2026

P Ë R

ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT
BAZË, SESIONI I DYTË, VITI SHKOLLOR 2025-2026

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrin nr. 578, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë të sesionit të dytë, për vitin shkollor 2025-2026, të zhvillohen në datat si më poshtë:
 - a) Lënda “Gjuhë shqipe” 25 gusht 2026.
 - b) Lënda “Matematikë” 28 gusht 2026.
 - c) Lënda “Gjuhë e huaj” e parë 1 shtator 2026.
 - d) Lënda “Gjuhë amtare” për nxënësit e pakicave kombëtare 26 gusht 2026.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët: “Gjuhë amtare”, “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe sipas dëshirës edhe në një gjuhë të huaj.
3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 74, datë 15.02.2024 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.
4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht” dhe “Gjermanisht”. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.
6. Provimet fillojnë në orën 10:00 dhe çdo provim zgjat 2 orë e 30 minuta.
7. Nxënësit me aftësi të kufizuar që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.
8. Drejtuesi i Qendrës Burimore “Ramazan Kabashi” e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
9. Çdo zyrë vendore e arsimit parauniversitar merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në QSHA.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

Konceptoi:	M. Mehmetaj		17.7.2018
Pranoi:	A. Ferizaj		17.7.2018
Miratoi:	Sh. Allkaj V. Koçi		
	M. Cami J. Çollaku		
Konfirmoi:	J. Suli		
Data te SP:			
Nr. i kopjeve:	3 (tre)		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR

Nr. 5835 prot.

Tiranë, më 24.07.2026

MEMO

Lënda: Draftudhëzimi “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026”

Drejtuar: Znj. Mirela Kumbaro, Furrxi, Ministër

Konfirmoi: Znj. Orjana Osmani, Zëvendësministre
Znj. Jona Suli, Sekretar i Përgjithshëm

Miratoi: Znj. Mirela Cami, Drejtor i Përgjithshëm
Z. Shkëlqim Allkaj, Drejtor drejtorie

Pranoi: Znj. Anila Ferizaj, Përgjegjës sektori

Konceptoi: Znj. Majlinda Mehmetaj, Specialist

Datë: 17.07.2026

E nderuar znj. Ministre,

Bazuar në nenin 50 të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, miratuar me urdhrin nr. 74, datë 15.02.2024 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Programeve të Arsimit Parauniversitar ka hartuar draftudhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026”.

Draftudhëzimi është dërguar për mendim në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, cila ka propozuar datat e zhvillimit të provimeve, ndërsa AKAP ka shprehur dakordësinë për draftin.

Në draftudhëzim janë përcaktuar lëndët dhe datat e zhvillimit të provimeve, kohëzgjatja e provimeve, organizimi dhe administrimi i tyre, si dhe institucionet përgjegjëse për mbarrëvajtjen e procesit.

Për sa më sipër, bashkëlidhur gjeni për miratim draftudhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026”, i cili është vlerësuar edhe nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

Duke Ju falënderuar,

Majlinda Mehmetaj

From: Voltisa Koci
Sent: Friday, July 17, 2026 11:42 AM
To: Shkelqim Allkaj
Cc: Fadil Reka; Majlinda Mehmetaj; Anila Ferizaj; Etjola Kola; Mirela Cami; Jonida Collaku; Jona Suli
Subject: RE: draftudhëzimi i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026
Attachments: 6.7.2026 DRAFT UDHEZIM PKAB SESIONI 2, 2025-2026.docx

Pershendetje,

Shprehemi dakord me permbajtjen e projekt-udhezimit dhe te aspektit te teknikes legjislative te tij.

Faleminderit.

Voltisa

From: Shkelqim Allkaj <Shkelqim.Allkaj@arsimi.gov.al>
Sent: Friday, July 10, 2026 12:48 PM
To: Etjola Kola <Etjola.Kola@arsimi.gov.al>; Voltisa Koci <Voltisa.Koci@arsimi.gov.al>
Cc: Fadil Reka <Fadil.Reka@arsimi.gov.al>; Majlinda Mehmetaj <majlinda.mehmetaj@arsimi.gov.al>; Anila Ferizaj <Anila.Ferizaj@arsimi.gov.al>; Mirela Cami <Mirela.Cami@arsimi.gov.al>; Jonida Collaku <Jonida.Collaku@arsimi.gov.al>; Jona Suli <Jona.Suli@arsimi.gov.al>
Subject: FW: draftudhëzimi i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026

Përshëndetje,

Bashkëlidhur gjeni për vlerësim draftudhëzimin e PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026.

Lutemi vlerësimin tuaj.

Faleminderit!



SHKËLQIM ALLKAJ

DREJTOR I ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR | DIRECTOR OF POLICY AND PROGRAM
DEVELOPMENT IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION

Ministria e Arsimit | Ministry of Education

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë, Shqipëri

shkelqim.allkaj@arsimi.gov.al | www.arsimi.gov.al

Majlinda Mehmetaj

From: Bora Habili
Sent: Thursday, July 9, 2026 4:40 PM
To: Majlinda Mehmetaj
Cc: Aida Myrto; Anis Thodhorjani; Enisa Dervishi; Mirela Cami; Shkelqim Allkaj; Anila Ferizaj
Subject: Re: Draftudhëzim i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026.

Përshëndetje,

Në vijim të email-it tuaj, QSHA **sugjeron** datat sa më poshtë:

1. Lënda "Gjuhë shqipe", më 25 gusht 2026.
2. Lënda "Matematikë", më 28 gusht 2026.
3. Lënda "Gjuhë e huaj" e parë, më 1 shtator 2026.
4. Lënda "Gjuhë amtare", për nxënësit e pakicave kombëtare më 26 gusht 2026.

Faleminderit,

Bora Habili

Drejtor/Director

Drejtoria e Vlerësimit të Arritjeve dhe Performancës Arsimore/ Directorate of Assessment of Achievements and Educational Performance

Qendra e Shërbimeve Arsimore / National Educational Services Center - Enic - Albania

Ministria e Arsimit/ Ministry of Education

E-mail: bora.habili@qsha.gov.al

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23. Tiranë

Tiranë, 1001 Shqipëri

From: Majlinda Mehmetaj <majlinda.mehmetaj@arsimi.gov.al>

Sent: Thursday, July 9, 2026 11:32 AM

To: Aida Myrto <Aida.Myrto@qsha.gov.al>; Bora Habili <Bora.Habili@qsha.gov.al>; Info Qsha <Info@qsha.gov.al>

Cc: Mirela Cami <Mirela.Cami@arsimi.gov.al>; Shkelqim Allkaj <Shkelqim.Allkaj@arsimi.gov.al>; Anila Ferizaj <Anila.Ferizaj@arsimi.gov.al>

Subject: RE: Draftudhëzimi i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026.

Përshëndetje,

Në vijim të komunikimit të mëposhtëm, lutemi caktoni datën e zhvillimit të provimit për secilën nga lëndët e mëposhtme, sikurse është përcaktuar në pikën 1, të draftudhëzimit të PKAB sesioni i dytë 2025-2026, bashkëlidhur të dërguar nga MA, përmes email-it të datës 06.07.2026:

- a. Lënda "Gjuhë shqipe", më data, muaji, 2026.
- b. Lënda "Matematikë", më data, muaji, 2026.
- c. Lënda "Gjuhë e huaj" e parë, më data, muaji, 2026.

d' Lënda "Gjuhë amtare", për nxënësit e pakicave kombëtare më data, muaji, 2026

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



MAJLINDA MEHMETAJ

Specialiste | Specialist

Sektori i Vlerësimit dhe Administrimit të Kurrikulës dhe
Programeve të Arsimit Parauniversitar | Sector of Evaluation and
Administration of Curriculum and Pre-University Education
Programs

Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Programeve të Arsimit
Parauniversitar | Directorate of Development of Pre-University
Education Policies and Programs

Ministria e Arsimit | Ministry of Education

(E): majlinda.mehmetaj@arsimi.gov.al

From: Aida Myrto <Aida.Myrto@qsha.gov.al>

Sent: Wednesday, July 8, 2026 11:01 AM

To: Shkelqim Allkaj <Shkelqim.Allkaj@arsimi.gov.al>; Info Qsha <Info@qsha.gov.al>; Bora Habili
<Bora.Habili@qsha.gov.al>

Cc: Majlinda Mehmetaj <majlinda.mehmetaj@arsimi.gov.al>; Anila Ferizaj <Anila.Ferizaj@arsimi.gov.al>; Mirela Cami
<Mirela.Cami@arsimi.gov.al>; Orjana Osmani <Orjana.Osmani@arsimi.gov.al>; Jona Suli <Jona.Suli@arsimi.gov.al>

Subject: Re: Draftudhëzim i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026.

Pershendetje,

Per datat e sesionit te dyte propozojme:

25 gusht

28 gusht

2 shtator.

Faleminderit,
Aida

Aida Myrto, PhD

Drejtor i Përgjithshëm | General Director

Qendra e Shërbimeve Arsimore | National Educational Services Center - ENIC - Albania

Adresa/Address: Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.23, Tiranë, 1001, Albania

From: Shkelqim Allkaj <Shkelqim.Allkaj@arsimi.gov.al>

Sent: Monday, July 6, 2026 4:32 PM

To: Aida Myrto <Aida.Myrto@qsha.gov.al>; Info Qsha <Info@qsha.gov.al>

Cc: Majlinda Mehmetaj <majlinda.mehmetaj@arsimi.gov.al>; Anila Ferizaj <Anila.Ferizaj@arsimi.gov.al>;

Mirela Cami <Mirela.Cami@arsimi.gov.al>; Erzen Tola <Erzen.Tola@arsimi.gov.al>; Orjana Osmani

<Orjana.Osmani@arsimi.gov.al>

Subject: FW: Draftudhëzim i PKAB, sesioni i dytë, viti shkollor 2025-2026.

Bashkëlidhur gjeni draftudhëzimin e PKAB, sesi i dytë, për vitin shkollor 2025-2026.

Për sa më sipër lutemi deri në datë 10.07.2026, për komente/sugjerime dhe caktimin e datave të provimeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



SHKËLQIM ALLKAJ

DREJTOR I ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR | DIRECTOR OF POLICY AND PROGRAM
DEVELOPMENT IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION

Ministria e Arsimit | Ministry of Education

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë, Shqipëri

shkelqim.allkaj@arsimi.gov.al | www.arsimi.gov.al



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct.



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct.